Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/26-V060282/26 **dt.** 14.10.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me Vendimin Nr.Prot.1459/26, dt. 19.08.2026, si dhe Kërkesën elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 08.10.2026, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M
(Për Fillimin e procesit për Hartimin e Planit të Integritetit)

1. Të filloj procesi për Hartimin e Planit të Integritetit në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2027-2029.

2. Emërohet znj. Teuta Selmani Pllana si Koordinatore e Procesit të Hartimit të Planit të Integritetit.

3. Të formohet Grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit me Vendim të veçantë.

4. Afati për dorëzimin e draftit të Planit të Integritetit është dt. 24.12.2026.

A r s y e t i m

Ky vendim është nxjerrë më qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim forcimin e integritetit institucional, identifikimin e rreziqeve të korrupsionit dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

Shtojcë:
Email-i nga Zyra e Kryetarit, dt. 08.10.2026.

T'i dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 znj. Teuta Selmani Pllana/Kordinatores
1x1 Anëtarëve të ardhshëm të Grupit Punues
1x1 Arkivit